



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 57, datë 07.02.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR
POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE TË SHPALLURA
ME VENDIMET NR. 239 – Nr. 247 DATË 24.05.2023
DHE GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT PËR POZICIONET E LIRA
TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 235- NR. 238 DATË 24.05.2023
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

(Ndryshuar me vendimin nr. 120, datë 06.03.2024)

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 07.02.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përparitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si dhe pasi shqyrtoi propozimin përkatës,

VËREN

I. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239 – nr. 247 datë 24.05.2023

1. Në Mbledhjen Plenare të datës 24.05.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 86, shkronja “ç”, i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar), me vendimet **nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023** Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi

procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. (9 pozicione të lira në fushën civile).

2. Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë si më lart u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej **30 (tridhjetë)** kandidatura, të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të prezantuar si më sipër.

4. Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta ose të specializuara, gjen rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në pikën 7 të nenit 48, përcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

5. Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” të ndryshuar. Pikërisht, në respektim të këtij akti, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet respektive nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 të datës 24.05.2023

II. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira, nr. 235, 236, 237 dhe nr. 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Në Mbledhjen Plenare të datës 24.05.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 86, shkronja “ç”, i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar), me vendimet **nr. 235, 236, 237 dhe nr. 238 datë 24.05.2023** (4 pozicione të lira). Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në **Gjykatën Administrative të Apelit**.

7. Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë si më lart u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

8. Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej **13 (trembëdhjetë)** kandidatura, të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes për pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit të prezantuara si më sipër.

9. Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta ose të specializuara, gjen rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 48, ku në pikën 7 të kësaj dispozite, pëcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

10. Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” të ndryshuar. Sipas këtij akti nënligjor, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet respektive nr. 235, 236, 237 dhe nr. 238 të datës 24.05.2023.

III. MBI KANDIDATURAT E PARAQITURA

11. Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të hapur sipas vendimeve si më lart të Këshillit, datë 24.05.2023 kandiduan gjithsej **30 (tridhjetë)** kandidatë, dhe konkretisht:

1. Besjana Garxenaj	241, 244, 245
2. Klodiana Veizi ¹	239 deri 247
3. Matilda Fetau	247
4. Adelajda Gjuzi	240
5. Besmir Stroka ²	241, 243, 247
6. Diamela Goxha ³	241, 243
7. Altin Shkurti	240
8. Taulant Banushi	241
9. Matilda Llangozi	245
10. Anila Guri	244, 245
11. Esmerilda Habili	239, 244, 247
12. Marinela Osmani	244

¹ Ka më tepër se 3 aplikime.

² Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 499, 500 dhe 501 në proces.

³ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 129 dhe 500 në proces.

13. Esmeralda Xhili	244
14. Ersida Bajgora ⁴	243, 246, 247
15. Enkela Vlora	239, 240, 243
16. Antonela Prendi	241, 246, 247
17. Ervin Pollozhani	242, 246, 247
18. Gentian Marku ⁵	245, 246, 247
19. Dritan Caka	244, 246, 247
20. Entela Shedula	240, 245, 247
21. Anila Karanxha	242, 244, 247
22. Olkeda Lice ⁶	242, 244, 246
23. Laurent Fuçia ⁷	241, 243, 245
24. Markelian Koça ⁸	239, 247
25. Niko Rapi ⁹	239
26. Arben Dosti	244, 246
27. Engjëllushe Tahiri ¹⁰	239 deri 247
28. Artan Jahollari ¹¹	241, 246
29. Nurjeta Pogaçe	246
30. Albert Meça	245

12. Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit të hapur sipas vendimeve si më lart të Këshillit, datë 24.05.2023 kandiduan gjithsej **11 (njëmbëdhjetë)** kandidatë, dhe konkretisht:

1. Altin Shkurti	235, 236
2. Elvana Çiçolli	235, 238
3. Gentiana Muçaj ¹²	236, 237, 238
4. Elda Vrioni	236, 237, 238
5. Anila Guri	235
6. Nafije Hasko	236, 237, 238
7. Alma Kodraliu	236
8. Gerd Hoxha ¹³	235
9. Selvie Gjoçaj	236, 237, 238
10. Etleva Gjamo	236, 237, 238
11. Albert Meça	237

⁴ Ka hequr dorë nga këto aplikime me shkresën nr. 5754/1 prot., datë 03.11.2023.

⁵ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet LP Tiranë 18 dhe 20 në proces.

⁶ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 15 LP Tiranë dhe 503 e 504 në proces.

⁷ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 500, 501 dhe 503 në proces.

⁸ Ka hequr dorë me kërkesën datë 16.01.2024.

⁹ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 502, 503 dhe 504 në proces.

¹⁰ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 502 dhe 503 në proces.

¹¹ Ka hequr dorë nga këto pozicione më kërkesën nr. 5079 prot., datë 29.09.2023.

¹² Hequr dorë nga këto pozicione më kërkesën datë

¹³ Ka më tepër se 3 aplikime, pozicionet 449, 502, 503 në proces.

13. Referuar kandidaturave të paraqitura, rezulton se disa prej kandidatëve kanë kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në gjykatat më të larta /ose lëvizje paralele dhe kanë më tepër se 3 (tre) aplikime në proces. Këta kandidatë ndahen në dy(2) grupe.

13.1 Në grupin e parë përfshihen kandidatët të cilët kanë më shumë se 3(tre) aplikime në proces dhe *nuk kanë paraqitur dorëheqje deri më datë 14.06.2023* – (datë në cilën përfundoi afati i paraqitjes së aplikimeve).

13.2 Konkretisht kandidatët:

- **Klodiana Veizi**, ka aplikuar në pozicionet nr. 239 deri nr. 247 – 9 pozicione gjithsej.
- **Diamela Goxha**, ka aplikuar në pozicionet 241, 243, duke pasur ende në garë pozicionet nr.129 dhe nr. 500 – 4 pozicione gjithsej.
- **Laurent Fuçia** - ka aplikuar në pozicionet 241, 243, 245, duke pasur në proces pozicionet 500, 501 dhe 503 – 6 pozicione gjithsej.
- **Niko Rapi** - ka aplikuar në pozicionin 239, duke pasur në proces pozicionet 502, 503 dhe 504 -4 pozicione gjithsej.
- Engjëllushe Tahiri** - ka aplikuar në pozicionet 239 deri 247, duke pasur në proces pozicionet 502 dhe 503 – 11 pozicione gjithsej.
- **Gentian Marku**, - ka aplikuar në pozicionet 245, 246, 247 i cili ka pasur në proces edhe pozicionet nr. 18 dhe nr. 20 të lëvizjes paralele për Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë– 5 pozicione gjithsej.

13.3 Në grupin e dytë përfshihen kandidatët të cilët në kohën e kandidimit kanë pasur më shumë se 3(tre) kandidatura në proces dhe *kanë hequr dorë nga aplikime të mëparshme pas datës 14.06.2023* – (datë në cilën përfundoi afati i paraqitjes së aplikimeve).

13.4 Konkretisht kandidatët:

- **Besmir Stroka**, ka aplikuar në pozicionet nr. 241, 243, 247 dhe ndërkohë ka në proces pozicionet nr. 499, 500 dhe 501 – gjithsej 6 pozicione.

Më datë 21.06.2024 nëpërmjet postës elektronike z. Stroka ka shprehur vullnetin për të hequr dorë nga pozicioni që i përket vendimit nr. 499 dhe mbajtur në konkurrim pozicionet që i përkasin vendimeve nr. 500 dhe nr. 501 pranë GjKKO dhe pozicionin që i përket vendimit nr. 243 për seksionin civil të GjAJP.

Lidhur me kërkesën për heqjen dorë nga pozicioni nr. 499 – Këshilli nuk është shprehur.

- **Olkeda Lice**, ka aplikuar në pozicionet nr. 242, 244 dhe 246, cila ka pasur në proces pozicionet 15 LP Tiranë dhe 503 e 504 për ngritje në detyrë - gjithsej 6 pozicione.

Në datë 23.06.2024 i është drejtuar Këshillit me kërkesën nr. 3671/1 prot, për heqje dorë dhe rikonsiderime pozicionesh, duke shprehur se *vijon aplikimin* për pozicionin nr. 242, 503 dhe lëvizjen paralele nr. 15 dhe heq dorë nga pozicionet 504, 244, 246.

Në vijim më datë 07.07.2023 i është drejtuar Këshillit me kërkesë për rikonsiderim të pozicioneve të lira, duke u shprehur se: *“Në kushtet kur kërkesa e nisur më datë 23.06.2023 nuk është marrë në shqyrtim dhe në kushtet kur jam duke rikonsideruar edhe një herë kërkesat për pozicionet e lira, duke: shfaqur vullnetin se heq dorë nga aplikimi për lëvizje paralele. – shfaq vullnetin se heq dorë nga kërkesa për heqje dorë nga aplikimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të gjyqtarit pranë GjAJP, shpallur me vendimin nr.244...”*

Pozicionet e lira ku vijoj aplikimin janë 503, 242, 244.

Sa i përket lëvizjes paralele në Tiranë – pozicioni nr. 15- kërkesa e saj për heqje dorë është miratuar nga Këshilli.

- **Gerd Hoxha** – ka aplikuar në pozicionin nr. 235, duke pasur në proces pozicionet 449, 502, 503 – gjithsej 4 pozicione.

Me kërkesën nr. 3584 *prot., datë 21.06.2023* ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga pozicioni nr. 503. Për këtë kërkesë për heqje dorë Këshilli është shprehur me vendimin nr.503, datë 28.09.2023.

IV. VLERËSIMI I KËSHILLIT

14. Referuar kërkesave të kandidatëve rezultojnë disa kandidatë të cilët kanë hequr dorë nga procedura e ngritjes në detyrë *përpara* fillimit të verifikimit, konkretisht: i) z. Markelian Koça; ii) znj. Gentiana Muçaj; iii) znj. Ersida Bajgora dhe iv) z. Artan Jahollari – pra për ta nuk fillon procedura e verifikimit sipas këtij vendimi.

15. Sa i përket kandidatëve të tjerë, të përmendur në pikën 13.2 dhe 13.4 të këtij vendimi, Këshilli, çmon të parashtrorë se: Në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁴, përcaktohet se: *“6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës”.*

15. Në konsideratë të këtij përcaktimi ligjor, në Njoftimet Publike të datës 25.05.2023, të interesuarve iu është bërë e ditur se: *“Në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:*

Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme

¹⁴ Ndryshuar me Ligjin nr. 50/2021.

ngritjeje në detyrë. - Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës, qofshin këto procedura të ngritjes në detyrë ose lëvizje paralele.

Nëse magistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.

Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar ose kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.”

16. Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore për kandidatët me më tepër se 3(aplikime), të vlefshme do të konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, prej tyre. Në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë do të konsiderohen ato kandidime që janë renditur sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura nga Këshilli, duke filluar nga ai i shpalluri më parë.

Më konkretisht:

znj. Klodiana Veizi, e cila ka aplikuar në pozicionet nr. 239 deri nr. 247, do të ketë aplikime të vlefshme ato të pozicioneve të lira nr. **239, 240 dhe nr. 241.**

znj. Diamela Goxha, e cila ka aplikuar në pozicionet 241, 243, duke pasur ende në garë pozicionet nr.129 dhe nr. 500, do të ketë aplikime të vlefshme nr. 129, nr. 500 dhe nr. 241. Në kushtet kur kjo aplikante është kandidat e vetme në garë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin nr. 129, dhe për të është propozuar ngritja në detyrë, Këshilli vlerëson që për këtë kandidatë të mos fillojë procedura e verifikimit sipas këtij vendimi.

z. Laurent Fuçia – i cili ka aplikuar në pozicionet 241, 243, 245, duke pasur në proces pozicionet 500, 501 dhe 503, do të ketë aplikime të vlefshme ato nr. **500, 501 dhe 503 – nuk është subjekt i verifikimit sipas këtij vendimi.**

z. Niko Rapi – i cili ka aplikuar në pozicionin 239, duke pasur në proces pozicionet 502, 503 dhe 504, do të ketë aplikime të vlefshme ato nr. **502, 503 dhe 504 - nuk është subjekt i verifikimit sipas këtij vendimi.**

znj. Engjëllushe Tahiri – e cila ka aplikuar në pozicionet 239 deri 247, duke pasur në proces pozicionet 502 dhe 503, do të ketë aplikime të vlefshme ato të pozicioneve të lira nr. **502, 503 dhe nr. 239.**

z. Gentian Marku, - i cili ka aplikuar në pozicionet 245, 246, 247, duke pasur në proces edhe pozicionet nr. 18 dhe nr. 20 të lëvizjes paralele – do të ketë aplikime të vlefshme ato të pozicioneve të lira **nr.18, nr. 20 dhe nr.245.**

17. Kandidatët e përmendur në pikën 13.4 të këtij vendimi, e kanë paraqitur kërkesën për heqje dorë nga pozicione të mëparshme jashtë afatit të kandidimit për pozicionet e reja në proces. Thënë ndryshe në momentin e aplikimit kanë pasur më tepër se tri kandidatura të vlefshme.

Për 1(një) nga këta kandidatë kërkesa për heqje dorë nuk është marrë në shqyrtim nga Këshilli. (z. Besmir Stroka). Aplikime të vlefshme këtë kandidat janë aplikimet e bëra më parë në kohë.

Konkretisht për z. Stroka vlejné aplikimet për pozicionet **nr. 499, 500 dhe 501**. Vullneti i tij për heqjen dorë nga pozicioni nr. 499 do të duhet të verifikohet nga relatori përkatës.

Për z. Hoxha, i cili ka pasur më parë pozicionet 449, 502, 503. Vullneti i tij për heqjen dorë nga pozicioni nr. 503 është verifikuar me vendimin nr. 503, datë 28.09.2023. Aplikime të vlefshme në proces mbeten ato për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 449 dhe nr.502.

Për znj. Olkeda Lice në kushtet kur ka shprehur vullnetin për heqje dorë për lëvizjen paralele – pozicioni nr. 15, Këshilli me vendimin nr. 384, datë 17.07.2023 ka vendosur ndër të tjera: *“Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. Olkeda Lice, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.”*

Sa më sipër aplikime të vlefshme znj. Olkeda Lice do të ketë ato të pozicioneve **të lira nr. 503 dhe nr. 504**. Sa i përket heqjes dorë nga **pozicioni 504**, vullneti i saj do të verifikohet nga relatori përkatës.

18. Për sa më sipër, në konsideratë të parashikimeve ligjore në pikën 6 të Nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për këta kandidatë do të vlejné aplikimet e para.

18.1 Sa i përket vullnetit për heqje dorë për z. Stroka dhe znj. Lice në kushtet kur nga Këshilli nuk ka një vendim për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të verifikohet nga relatorët përkatës nëse do të vijojné aplikimet e mëparshme.

19. Në arritjen e këtij konkluzioni Këshilli ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2020-995, datë 28.12.2020, ku arsyetohet se: *“...68. Kjo mënyrë konceptimi nga ana e ligjit e mundësisë për kandidim merr vlerë dhe relevancë juridike, në rastet kur vendet e shpallura vakante janë më shumë se tre dhe se të gjitha eventualitetet e këtij lloji paraqesin një vëllim pune të shtuar dhe të konsiderueshëm për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Për rrjedhojë, ligji përmes këtij kufizimi ka kërkuar të mos ngarkojë procedurën e ngritjes në detyrë, ku konkurrimi mund të rezultojë fiktiv, në kushtet e përzgjedhjes së tyre si gjyqtarë në gjykatën me juridiksion lëndor të posaçëm apo më të lartë. Kjo do të thotë se ligji ka synuar të shmangë situatat e pakufizuara të kandidimeve fiktive apo të pafrytshme dhe të ushtruara nga kandidatët thjeshtë dhe me qëllimin e vetëm për të shtuar mundësitë dhe*

probabilitetin e suksesit në procedurën e ngritjes në detyrë. Përmes këtij kufizimi, ligji ka dashur të ndërgjegjësojë dhe të bëjë kandidatët konkurrues të përgjegjshëm për rëndësinë e vendimmarrjes së tyre në iniciativën e ushtrimit të kërkesës për kandidim në pozicionet e shpallura të lira dhe të hapura për garë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

69. Kjo do të thotë se përzgjedhja e interpretimit më të pranueshëm të nenit 48, pika 6 të Ligjit nr. 96/2016 do të duhet të bëhet sipas kriterit që nuk prevalon vetëm interesin e kandidatit për t'u ngritur detyrimisht në detyrë dhe për të shtuar probabilitetin e zhvillimit të karrierës së tij/saj, por do të duhet të bëhet sipas konkluzionit që arrin të mbrojë edhe interesin publik të mirëadministrimit të procedurës plurale të ngritjes në detyrë që zhvillon Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për rrjedhojë. Kolegji konkludon se interpretimi sipas të cilit neni 48, pika 6 të Ligjit nr. 96/2016 lejon kandidatët të konkurojnë për më shumë se tre pozicione vakante për ngritjen në detyrë nuk pajtohet me të gjitha kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, pasi mohon qëllimet ligjore për mirëadministrimin e proceseve të ngritjes në detyrë të magjistratëve prej Këshillit të Lartë Gjyqësor.

70. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë respektuar nenin 17 të Kushtetutës në mënyrën se si kanë interpretuar nenin 48, pika 6 të Ligjit nr. 96/2016 dhe se interpretimi rishtazi i kësaj dispozite nuk është bërë në mënyrë të papritur, të paaksesueshme dhe të paparashikueshme për palën rekursese. Për rrjedhojë, paditësi nuk është vënë para efektit surprizë të vendimmarrjes administrative apo gjyqësore.

71. Kolegji vlerëson se ky interpretim ligjor përbën kufizim me ligj dhe nuk cenon në thelb të drejtën e paditësit për tu promovuar. Nisur nga kjo analizë kushtetuese e interpretimit të nenit 48, pika 6 e Ligjit nr. 96/2016, në raport edhe me nenin 43/5 të Ligjit, nuk ka rëndësi nëse gjyqtari kandidon për gjykata të ndryshme apo brenda të njëjtës gjykatë apo edhe në të njëjtën fushë të së drejtës, pasi ky kufizim duhet të zbatohet, në çdo rast, për qëllimet e mbarëvajtjes së proceseve paralele administrative dhe prurale të ngritjes në detyrë."

20. Sa i përket kandidatëve të cilët kanë pasur aplikime të vlefshme të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, por për të cilët aktualisht Këshilli ka vendosur transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele, gjendja e aplikimeve të tyre do të verifikohet nga relatorët përkatës dhe do të vlerësohen nga Këshilli sipas parashikimeve të pikës 5 të Nenit 43 dhe pikës 6 të Nenit 48 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, gjatë procedurës për verifikimin e plotësimit nga kandidatët të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja "ç", të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 43 pika 5 dhe 48 pika 6 dhe 7, të

Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:
 1. Për kandidaten znj. Besjana Garxenaj - relator z. Ridvan Hado;
 2. Për kandidaten znj. Klodiana Veizi - relator z. Klodian Kurushi;
 3. Për kandidaten znj. Matilda Fetau - relator z. Alban Toro;
 4. Për kandidaten znj. Adelajda Gjuzi - relator z. Klodian Kurushi;
 5. Për kandidatin z. Altin Shkurti - relator z. Klodian Kurushi;
 6. Për kandidatin z. Taulant Banushi - relator z. Ridvan Hado;
 7. Për kandidaten znj. Matilda Llangozi - relator z. Alban Toro;
 8. Për kandidaten znj. Anila Guri - relator z. Klodian Kurushi;
 9. Për kandidaten znj. Esmerilda Habili - relator z. Ridvan Hado;
 10. Për kandidaten znj. Marinela Osmani - relator z. Klodian Kurushi;
 11. Për kandidaten znj. Esmeralda Xhili - relator z. Klodian Kurushi;
 12. Për kandidaten znj. Enkela Vlora - relator z. Alban Toro;
 13. Për kandidaten znj. Antonela Prendi - relator z. Ridvan Hado;
 14. Për kandidatin z. Ervin Pollozhani - relator z. Ridvan Hado;
 15. Për kandidatin z. Gentian Marku - relator z. Ridvan Hado;
 16. Për kandidatin z. Dritan Caka - relator z. Klodian Kurushi;
 17. Për kandidaten znj. Entela Shedula - relator z. Ridvan Hado;
 18. Për kandidaten znj. Anila Karanxha - relator z. Klodian Kurushi;
 19. Për kandidatin z. Arben Dosti - relator z. Ridvan Hado;
 20. Për kandidaten znj. Engjëllushë Tahiri - relator z. Alban Toro;
 21. Për kandidaten znj. Nurjeta Pogaçe - relator z. Klodian Kurushi;

- | | |
|--|--|
| 22. Për kandidatin z. Albert Meça | - relator z. Ridvan Hado ¹⁵ ; |
| 23. Për kandidaten znj. Elvana Çiçolli | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 24. Për kandidaten znj. Elda Vrioni | - relator z. Alban Toro; |
| 25. Për kandidaten znj. Nafije Hasko | - relator z. Alban Toro; |
| 26. Për kandidaten znj. Alma Kodraliu | - relator z. Ridvan Hado; |
| 27. Për kandidaten znj. Selvie Gjoçaj | - relator z. Alban Toro; |
| 28. Për kandidaten znj. Etleva Gjamo | - relator z. Alban Toro; |

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

¹⁵ Ndryshuar me vendimin nr. 120, datë 06.03.2024.